



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

K.DH.SH.II.nr.628/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS – Dhomat e Shkallës së Dytë, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Krenar Berisha, kryetar i kolegjit, Dren Rogova dhe Ramush Bardiqi, anëtar të kolegjit, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditëses Hekurudhat e Kosovës “Trainkos” SH.A me seli në Fushë Kosovë rr.Sheshi i Lirisë nr.22, e përfaqësuar me autorizim nga K.P., K.TH. dhe V.V., kundër të paditurës Autoriteti Rregullativ i Hekurudhave, i përfaqësuar me autorizim nga D.R., V.H. dhe A.M. me bazë juridike, anulim vendimi, duke vendosur lidhur me ankesën e paditëses të ushtruar kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, A.nr.653/16 të datës 05.11.2020, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 06.07.2023, merr këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa e paditëses Hekurudhat e Kosovës “Trainkos” SH.A me seli në Fushë Kosovë, ndërsa Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për çështje administrative, A.nr.653/2016 i datës 05.11.2020, Vërtetohet.

A r s y e t i m

Me Aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për çështje administrative, A.nr.653/2016 të datës 05.11.2020, është vendosur si në vijim: I Refuzohet si e pabazuar kërkesëpadija e paditëses Hekurudhat e Kosovës “Trainkos” SH.A me seli në Fushë Kosovë, me të cilën ka kërkuar që të anulohet si i kundërligjshëm vendimi i të paditurës Autoriteti Rregullativ i Hekurudhave (ARH) nr.LIC 04/2015 dates 11.12.2015, II Refuzohet si e pabazuar propozimi i të paditurës ARH dhe palës me interes juridik Rail Trans LLC, të cilat kanë kërkuar që padia e paditëses të hudhet poshtë si e paafatshme ose e palejuar, III Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale

Kundër këtij aktgjykimi ka ushtruar ankesë paditësja për shkak të: shkeljes thelbësore të dispozitave të procedurës dhe vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, duke propozuar që Gjykata e Apelit ta aprovoj ankesën e të paditëses, si e bazuar, aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për çështje administrative, A.nr.653/2016 të datës 05.11.2020, të Anulohet dhe të aprovohet padia si e bazuar ashtu që të anulohet vendimi nr.LIC 04/2015 datës 11.12.2015 i lëshuar nga e paditura për palën me interes.

Në përgjigjen në ankesë e paditura i propozon gjykatës së apelit, që ta refuzoj si të pabazuar ankesën e paditëses dhe ta vërtetoj aktgjykimin A.nr.653/2016 të datës 05.11.2020, me të cilin padia e paditëses është refuzuar si e pabazuar

Dhomat e Shkallës së Dytë, vlerësoi ligjshmërinë e aktgjykimit të ankimuar në kuptim të nenit 12 të Ligjit nr.08/L-015 për Gjykatën Komerciale, dhe nenit 49 të LKA-së, në drejtim të thënieve në ankesë, përgjigjes në ankesë, dhe pas shqyrtimit edhe të shkresave tjera të lëndës vlerëson se;

Ankesa është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësja Hekurudhat e Kosovës “Trainkos” SH.A me seli në Fushë Kosovë, ka ushtruar padi në gjykatë duke inicuar konflikt administrativ kundër të paditurës Autoriteti Rregullativ i Hekurudhave, respektivisht ka kundërshtuar vendimin nr. nr.LIC 04/2015 datës 11.12.2015 të paditurës, me arsyetimin se vendimi i kundërshtuar me padi është i pa drejtë dhe në kundërshtim me ligjin.

Gjykata e shkallës së parë, ka mbajtur seancën e shqyrtimit kryesor me datë 05.11.2020, pasi vlerësoi vendimin e kundërshtuar dhe pas administrimit të provave, vërtetoi gjendjen faktike në mënyrë të plotë dhe të drejtë duke u bazuar në provat siç janë: aktvendimi kontestues i të paditurës, certifikatat e sigurisë, licenca për kryerjen e shërbimit të transportit hekurudhor, certifikata në emër të Rail Trans datës 15.08.2018, si dhe shkresat tjera. Në arsyetim të aktgjykimit të atakuar theksohet se e paditura ka marrë parasysht rekomandimet nga aktgjykimi i plotfuqishëm i kësaj gjykate, me të cilin është vërtetuar se palës këtu me interes juridik Rail Trans, në mënyrë të kundërligjshme i është revokuar licenca për transport hekurudhor, të mallrave. Pretendimet e paditëses janë të pabazuar sepse janë në kundërshtim me gjendjen faktike të vërtetuar nga organi i paditur.

Dhomat e Shkallës së Dytë e Gjykatës Komerciale, këtë qëndrim juridik të gjykatës së shkallës së parë, e vlerëson si të rregullt dhe të bazuar në ligj, për arsye se aktgjykimi i atakuar nuk është përfshirë me zbatim të gabuar të dispozitave ligjore, të cilat shkelje gjykata e shkallës së dytë i heton sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 194 të Ligjit mbi Procedurën Kontestimore (LPK).

Gjykata e shkallës së parë duke vlerësuar ligjshmërinë e aktvendimit të kontestuar në kuptim të nenit 44 par.1 të Ligjit për Konfliktet Administrative (LKA), në drejtim të thënieve në padi, në përgjigje në padi, provave të administruara në seancë gjyqësore si dhe pas shqyrtimit të shkresave të tjera të lëndës, aktgjykimin e ka mbështetur kryesisht në gjendjen faktike të shkresave të lëndës, dhe faktit se e paditura në rivendosje, ka marrë për bazë rekomandimet e kësaj gjykate.

Dhomat e shkallës së dytë, vlerësoi se gjykata e shkallës së parë ka vendosur drejt kur ka refuzuar kërkesëpadinë e paditëses si të pabazuar. E njëjta gjykatë në rivendosje në vështrim të nenit 65 të LKA-së, e ka obliguar të paditurën të veprojnë sipas vërejtjeve të dhëna në aktgjykimin A.nr.506/2014, dt.08.06.2015. Tani duke vlerësuar se e paditura në rivendosje ka respektuar në tërësi vërejtjet e gjykatës, me vendimin kontestues në procedurë administrative, ka Njoh si valide Licencën për transport hekurudhor të mallrave për ndërmarrjen Rail Trans të lëshuar me datën 10.03.2014 nga Autoriteti Rregullativ i Hekurudhave, Kolegji gjen se gjykata e shkallës së parë, ka arsyetuar mjaftueshëm gjendjen faktike sa i përket dokumentacionit për Konfirmimin e

njohjes valide të Licencës për transport hekurudhor palës së interesuar Rail Trans, e lëshuar me datën 10.03.2014

Sa i përket pretendimeve ankimore se gjykata e shkallës së parë nuk ka respektuar asnjë nga dispozitat ligjore, Ligji 02/L-28 i LPA-së dhe Ligji nr.04/L-063 për Hekurudhat e Kosovës, dhe se vendimi administrativ është nxjerr nga personi nën aktakuzë, e cila është ngritur për këtë çështje administrative, Kolegji, vlerësoi se këto pretendime nuk janë të bazuara dhe të argumentuara në ligj, sepse gjykata e shkallës së parë, me rastin e shqyrtimit të padisë së paditëses, dhe provave të administruara, me të drejt ka nxjerr konstatimin se zyrtari në fjalë nuk është provuar se ka qenë i pezulluar nga puna apo ekziston ndonjë masë ndalese në ushtrimin e funksionit. Gjithashtu Kolegji nuk i pranoi si të bazuara pretendimet ankimore se aktgjykimi i atakuar përmban shkelje të dispozitave ligjore, të cilat mund të ndikojnë në një vendimmarrje ndryshe. Në konflikt administrativ të iniciuar me padi, gjykata e zhvillon procedurën sipas Ligjit 03/L-202 për Konfliktet Administrative, dhe shqyrton ligjshmërinë e aktit administrativ nga neni 44 par.1 i LKA-së, prandaj kjo gjykatë nuk pajtohet me pretendimet në ankesë se gjykata e shkallës së parë ka bërë shkelje të dispozitave të Ligjit 02/L-28 dhe Ligjit 04/L-063.

Nga tërë kjo që u cekë më lartë dhe mbi këtë gjendje faktike, Kolegji i Dhomës së Shkallës së Dytë, konsideron se gjendja faktike është vërtetuar drejtë dhe në mënyrë të plotë, ngase është nuk cënuar ligji në dëm të paditëses, thëniet e ankesës ky Kolegj nuk i aprovoi, sepse vlerësoi se pretendimet ankimore ishin pa ndikim në vërtetimin e gjendjes tjetër faktike nga ajo e vërtetuar edhe nga gjykata e shkallës së parë.

Nga arsyet e cekura, Kolegji i Dhomës së Shkallës së Dytë, gjeti se gjykata e shkallës së parë, në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme ka vendosur në këtë çështje juridike, prandaj në mbështetje të dispozitave nga neni 12 të Ligjit 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, lidhur me nenin 49 të LKA-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Dytë

K.DH.SH.II.nr.628/22 datë 06.07.2023

Kryetar i kolegjit,
Krenar Berisha